



Pranuar / Dorezuar Prilimjenal/Prodato Received/Delivered	15.03.2022	2	viti god year
Organ /Injesia Organ /Jedinitca Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKNMSHQ	1396/2022		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.78/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani – anëtar, si dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, kanë shqyrtuar ankesën e datës 01.02.2022 me numër A.nr.78/2022 të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë [redacted] në Komunën e Prishtinës kundër organit të punësimit Këshillit Prokurorial të Kosovës -Vendimit KA.nr.03/20221 me numër të protokollit 111/2022 të datës 24.01.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 15.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.78/2022 e datës 01.02.2022 e parashtruar nga ankuesi [redacted]
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numer KA.nr.03/2022 të datës 24.01.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

A r s y e t i m

Sekretariati i Këshillit Prokurorial i Kosovës, me datë 04.11.2021 ka shpallur konkursin e jashtëm për vendin e punës “Zyrtar ligjor 2”, në Prokurorin Themelore në Ferizaj, dy(2) pozita me numër referencës KPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/Poz-018, i hapur deri me datë 18.11.2021, në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, dhe ka qenë i përfshirë në të gjitha fazat e intervistës të testit me shkrim dhe me gojë .

I pa kënaqur me njoftimin e datës 17.12.2021 për përzgjedhjen përfundimtare të kandidatëve, ankuesi me datë 29.12.2021 parashtron ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës i cili me datës 24.01.2022 ka nxjerrë Vendimin me numer KA.nr.03/2022 me numër të

protokollit 111/2022 me të cilin ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e ankuesit [redacted] duke lënë në fuqi njoftimin e datës 17.12.2021 për përzgjedhjen përfundimtare për pozitën "Zyrat ligjor 2", për dy(2) pozita.

Ankuesi [redacted] kundër Vendimit me numer KA.nr.03/2021 111/2022 të datës 24.01.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, me datë 28.01.2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes postës së Kosovës nr. R 2125711, e pranuar me datë 01.02.2022 dhe e regjistruar me numër rendor A.nr.78/2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 22.02.2022, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës. Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, më datë 25.02.2022 ka përcjell dokumentacionin e kërkuar me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova:

Ankesa e ankuesit e datës 01.02.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes postës së Kosovës nr. R 2125711 të datës 28.01.2022; Përgjigje në ankesë e datës 25.02.2022; Ankesa e ankuesit e datës 29.12.2021 e parashtruar në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Vendimi KA.nr.03/2023 i datës 24.01.2022 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Konkursi i jashtëm i datës 04.11.2021; Regjistri i Aplikacioneve të Pranuara nga data 04.11.2021 deri me datë 18.11.2021; Njoftimi i datës 25.11.2021 i kandidatëve të përzgjedhur në listën e ngushtë; Përmbledhja e Vlerësimeve Individuale të Testi me Shkrim- rezultati i datës 07.12.2021; Aplikacioni i [redacted] për punësim i Form.MAP-SHCK-03 i datës 17.11.2021; Diplomë Universitare NR.5855 e datës 21.12.2018; Diplomë Universitare Programi Master NR.2574 e datës 07.06.2021; Mirënjohje maj 2018; Kontratë e punës e datës 01.12.2012, nga N.T.P Ferplast në seli në Ferizaj; Aktvendim i datës 30.04.2021; Pasqyra e trustit nga data 05.11.2018 deri me datë 10.11.2021; Vërtetim i praktikës gjyqësorë e datës 06.05.2019; Certificate e datës 30.04.2020 lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj; Kontratë e punës e datës 01.07.2021, me orar jo të plotë lëshuar nga SH.P.K"ELRPN", Njësia" POINT RENTA CAR", me seli në Ferizaj, me kohë të pacaktuar; Certificate e datës 17.11.2017 lëshuar nga EU Projekt; Certificate e datës 02.05.2021 lëshuar Universiteti i Prishtinës në bashkepunim me projektin "Council Europe"; Certificate e datës 23.08.2021 lëshuar Unioni Evropian në bashkepunim me projektin "Council Europe"; Certificate e gjuhës Angleze , nga testi TOEFL IBT ETS , i datës 28.08.2021; Letër rekomande e datës 05.02.2021 lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj; Referencë e datës 03.02.2021, lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj me performancë të bashkangjitur dhe Letër rekomanduese lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj; Certificate e datës 10.11.2021 për punësim, lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj (nuk është duke u zhvilluar procedurë penale); Aplikacioni i [redacted] për punësim i Form.MAP-SHCK-03 i datës 11.11.2021; Diplomë Universitare NR.5806 e datës 04.10.2018; Kontratë për punë praktike vullnetare në Prokurorinë e Shtetit e datës 07.11.2018 deri me datë 06.11.2019; Certificate e datës 07.11.2019 për kryerjen e stazhit të praktikantit në bazë vullnetare pa pagesë- Prokurorinë e Shtetit; Certificate qershor - nëntor 2020 e lëshua nga programi "YIHR"; Letër rekomande nga nëntori 2018 deri me nëntor 2019, lëshuar nga Prokuroria e Shtetit; Letër rekomande nga Gjykata Themelore Ferizaj (Gjyqtari për të mitur);

Certifikatë e datës 05.06.2019, lëshua nga programi "OSCE"; Certifikatë e datës 10.11.2021 për punësim, lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj (nuk është duke u zhvilluar procedurë penale); Aplikacioni i [redacted] për punësim i Form.MAP-SHCK-03 i datës 11.11.2021, me biografi CV të bashkangjitur; Diplomë Universitare NR.3087 e datës 20.03.2015; Certifikatë e datës 13.05.2019, lëshua nga Ministria e Drejtësisë; Certifikatë e datës 06.06.2017 për kryerjen e stazhit të praktikantit në bazë vullnetare pa pagesë - Prokurorinë e Shtetit; Certifikatë e datës 01.04.2016 për kryerjen e stazhit të praktikantit në bazë vullnetare pa pagesë - Prokurorinë e Shtetit; Letër motivues e datës 08.11.2021; Rekomande nga prokurori i shtetit; Referencë e datës 11.05.2017, lëshuar nga Prokuroria Themelore Ferizaj; Raporti i datës 08.05.2017 për lëndët e kryera; Vërtetim i datës 22.10.2021 i papunësisë lëshuar nga Agjencia e Punësimit; Certifikatë e datës 26.10.2021 për punësim, lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj (nuk është duke u zhvilluar procedurë penale); Përmbledhja e Vlerësimeve Individuale i datës 13.12.2021; Përmbledhja e Vlerësimeve Individuale të Testi dhe intervista i datës 15.12.2021; Deklarata për mos ekzistimin e konflikt të interesit e datës 01.12.2021, për [redacted] Testi me shkrim i datës 01.12.2021; Deklarata për mos ekzistimin e konflikt të interesit e datës 01.12.2021, për [redacted] Testi me shkrim i datës 01.12.2021; Deklarata për mos ekzistimin e konflikt të interesit e datës 01.12.2021, për [redacted] Testi me shkrim i datës 01.12.2021; kopje e nxjerr nga telefoni i datës 10.12.2021; E-mail i datës 25.01.2021; Renditja përfundimtare e kandidatëve Form-MAP-SHCK-10 i datës 16.12.2021; Njoftimi i datës 17.12.2021 për përzgjedhjen përfundimtare.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit [redacted] është e pabazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se përzgjedhja përfundimtare e kandidatëve në vendin e punës "Zyrtar ligjor 2", për dy (2) pozita, për Prokurorin Themelore në Ferizaj në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës është në kundërshtim me Ligjin dhe Rregulloren në fuqi duke theksuar se është i mbi kualifikuar dhe komisioni nuk ka marrë për bazë për ta përzgjedhur.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se në konkursin e shpallur të datës 04.11.2021 nga Këshillit Prokurorial të Kosovës për vendin e punës „Zyrtar ligjor 2“, dy pozita në Prokurorin Themelore në Ferizaj kriteret e konkursit kanë qenë:

- *Diplomë universitare: fakulteti juridik,*
- *Një (1) vit përvojë pune profesionale .*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se kandidatët e pranuar nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e konkursit, dhe pas shqyrtimit të të gjithave dëshmime për përgatitjen profesionale dhe përvojës së punës të bashkangjitur në dosjen e kandidatëve të përzgjedhur dhe të ankuesit, ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit është i paqëndrueshëm sepse, kandidatët e përzgjedhur dhe ankuesi janë përfshirë në listën e ngushtë dhe Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës i ka vlerësuar drejtë dhe në pajtim me nenin 28 paragrafit 1 nënparagrafi 1.2 neni 2, 3, 4 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil ku thuhet: "Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve në vijim:...,1.2. përvojën e punës", secili anëtar vlerëson kandidatin në secilin kriter. Numri maksimal i secilit kriter është 20 pikë. Numri

maksimal është 80, ndërsa minimumi për vazhdimin e kandidatit në procedura te tjera është 40 pikë. Kandidatet, të cilët nuk arrijnë numrin minimal të pikëve përjashtohet nga fazat e tjera të përzgjedhjes”.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka shqyrtuar pretendimin e ankuesit se komisioni përzgjedhës nuk i ka bërë vlerësimin real të kualifikimit në krahasim me kandidatët e përzgjedhur pasi që ata nuk e kanë provimin e jurisprudencës, ky pretendim nuk është i qëndrueshëm sepse kandidatët e përzgjedhura kanë kualifikim shkollor të kërkuar në pajtim me kriteret e konkursit të datës 04.11.2021 siç është kërkuar *Diplomë universitare: Fakulteti Juridik Një (1) vit përvojë pune profesionale*, sepse kandidatët e përzgjedhur në vendin e punës „Zyrtar ligjor 2”, dy pozita në Prokurorin Themelore në Ferizaj sepse kandidatja e përzgjedhur [redacted] e ka të kryer Fakultetin Juridik dhe ka diplomuar me datë 13.09.2018 në Universitetin e “Hasan Prishtina” në Prishtinë si dhe në bazë të dëshmime në dosje e ka plotësuar edhe kriterin e përvojës së punës sipas kontratës me NTP “Ferplas” [redacted] nga 07.01.2019 gjer më 30.04.2021 ka qenë në venin e punës “Zyrtare Ligjore” dhe sipas certifikatës të lëshuar nga Kryetari i Gjykatës Themelore në Ferizaj vërtetohet se [redacted] nga data 01.05.2019 gjer më datën 30.04.2020 ka kryer praktikën gjyqësore në Gjykatën Themelore në Ferizaj, ndërsa kandidatja e përzgjedhur [redacted] e ka të kryer Fakultetin Juridik dhe ka diplomuar me datë 28.06.2018 në Universitetin e “Hasan Prishtina” në Prishtinë si dhe në bazë të dëshmime në dosje e ka plotësuar edhe kriterin e përvojës së punës sipas certifikatës së datës 07.11.2019 me numër SKPK/DBNJ/Nr.02 të lëshuar nga Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore e Këshillit Prokurorial, [redacted] ka kryer stazhin e praktikës në kohëzgjatje prej një (1) viti nga data 07.11.2018 gjer më datën 06.11.2019 në Prokurorin Themelore në Ferizaj.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës në listë të ngushtë ka përfshirë edhe ankuesin dhe kandidatet e përzgjedhura sepse i kanë plotësuar kushtet dhe kriteret e konkursit të datës 04.11.2021.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, po ashtu ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil, gjatë zhvillimit të procedurës së rekrutimit deri në përzgjedhjen përfundimtare, ka vepruar drejtë duke bërë vlerësimet e testit me shkrim dhe me gojë si për ankuesen, po ashtu edhe për kandidatet e përzgjedhur duke vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 37 dhe 39 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, dhe në bazë të vlerësimeve të kandidateve të përzgjedhura [redacted] ka arritë gjithsejtë 85.1 pikët e përgjithshme nga testi me shkrim dhe intervista me gojë, dhe [redacted] ka arritë gjithsejtë 75.8 pikët e përgjithshme nga testi me shkrim dhe intervista me gojë, ndërsa ankuesi ka arritë gjithsejtë 59.2 pikët e përgjithshme nga testi me shkrim dhe intervista me gojë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se përzgjedhja e kandidatëve është bërë në pajtim edhe me dispozitat e nenit 40 paragrafi 1 dhe paragrafi 3 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *“Në shërbimin civil emërohen kandidatët të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë”, “Kandidat i suksesshëm konsiderohet ai, i cili në testin e përgjithshëm (testin me shkrim dhe me gojë) ka jo më pakë se 60% të maksimumit të pikëve të caktuara”,* në rastin konkret konkursi është shpallur për dy (2) pozita dhe në bazë të Formularit për renditjen përfundimtare

REPUBLIKË E KOSOVËS
KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVO
GOVERNMENT OF KOSOVO

të kandidatëve ankuesi pas vlerësimit të testit me shkrim dhe me gojë ka arritë gjithsejtë 59.2 pikët e përgjithshme, dhe është renditur i nëntëmbdhjeti (19) në listë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton që procedura e rekrutimit poziten elire "Zyrtar ligjor 2", për dy (2) pozita në Prokurorin Themelore në Ferizaj është zhvilluar në pajtim me nenin 3 paragrafin 9, nenin 5 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, nenin 11 paragrafin 1 dhe nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton që: *"Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitive të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paañsinë e komisionit testues, mosdiskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës"* dhe dispozitave të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numrin KA.nr.03/2022 me numër të protokollit 111/2022 të datës 24.01.2022, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.78/2022

Zyle Millaku Gojnovci

per: Wogandollit

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryefatë e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- Udhëheqëses së Personelit në Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMShCK-së.